



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:200779

Datë: 10.07.2024

Numri i dokumentit: 05920962

AA.nr.356/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, M.K, Komuna Vushtrrisë, të cilin e përfaqëson me autorizim avokat Nexhat Beqiri nga Vushtrria, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazën juridike: kërkesë për njohjen e së drejtës në përvojën e punës, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2072/2021, të datës 27.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit, M.K, Komuna Vushtrrisë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2072/2021, i datës 27.04.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2072/2021, të datës 27.04.2023, është hedhë poshtë si e parakohshme padia e paditësit, M.K, Komuna Vushtrrisë, me shenjën A.nr.2072/2021 e datës 09.09.2023, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë.

Kundër aktvendimit të lartcekur në afatin ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, avokat Nexhat Beqiri nga Vushtrria, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovet ankesa e paditësit si e bazuar dhe të anulohet aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë ashtu që të detyrohet e paditura ATK-ja që paditësit t ja paguaj shumën prej 0,5% të pagës bazë për çdo vit të plotë të përvojës në punë sipas rregullores e përcakton këtë shumë.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, si dhe nenit 194 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrativ (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka ushtruar padi me datën 06.09.2021, në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, për shkak të heshtjes së administratës sa i përket njohjes së 0,5% në emër të përvojës së punës, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës ATK në Prishtinë.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative me rastin e përgatitjes së shqyrtimit të çështjes, ka gjetur se padia e paditësit është jo e plotë, ngase nuk e ka precizuar saktë organin administrativ të paditur, vendimin përfundimtar në procedurë administrative, të cilin kërkon ta anulojë, ta precizojë kërkesë padinë si dhe nuk janë bashkangjitur shterja e mjeteve juridike para organit administrativ, përderisa padia është e paqartë dhe jo e plotë, gjykata me një padi të tillë nuk ka mundur të procedojë më tutje, andaj me aktvendimin A.nr.2072/2021 ka detyruar paditësin që në afat prej 8 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, ta bëjë precizimin e padisë duke precizuar saktë organin administrativ të

paditur, aktin administrativ përfundimtar të atakuar të cilin kërkon ta anuloj, ta precizoj qartë kërkesëpadinë, ta dorëzoj kopjen e aktit administrativ të kundërshtuar sipas padisë dhe ti dorëzoj gjykatës shterjen mjeteve juridike pranë organit administrativ të paditur, nën paralajmërimin se në qoftë se brenda afatit të caktuar si në pikën I të dispozitivit nuk vepron në kuptim të këtij aktvendimi të kësaj gjykate, kjo e fundit do të merr aktvendim me të cilin do t'ia hedhë poshtë padinë në kuptim të dispozitës së nenit 33.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Përfaqësuesi me autorizim i paditësit me datë 15.09.2022 ka dorëzuar parashtrësën për plotësimin dhe precizimin e padisë me të cilën ka theksuar mes tjerash se *organi administrativ i paditur është Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa akti administrativ nuk kemi por vetëm një përgjigje në bazë të kërkesës së paditësit e dt.08.06.2021, me të cilin thuhet se M.K nuk ka bërë asnjëherë kërkesë apo ankesë për pagesën 0.5 % për përvojën e punës.* Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin A.nr.2072/2021 të datës 23.11.2022, ka hedhur poshtë padinë e paditësit si të parakohshme. Duke vepruar sipas ankesës së paditësit Gjykata Apelit me aktvendimin AA.nr.38/23 datë 21.03.2023, ka aprovuar si të bazuar ankesën e paditësit dhe lënda kthehet në shkallën e parë në rigjykim dhe rivendosje. Mes tjerash theksohet që Gjykata e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar dhe arsyetuar faktin se paditësi kishte parashtruar padi për shkak të heshtjes administrative, pasi që më datë 08.06.2021 kishte parashtruar tek e paditura kërkesën me shkrim për njohjen e përvojës së punës, e paditura me datë 27.07.2021 kishte kthyer përgjigje me shkrim por nuk kishte nxjerrë vendimin administrativ ashtu siç kërkohet me LPPA për tu konsideruar më pastaj akti si në formën ashtu edhe në përmbajtje akti administrativ, andaj përgjigja me shkrim e të paditurës nuk mund të konsiderohet si akt administrativ e ku pastaj paditësi do ti lindte e drejta për të zhvilluar procedurën e mëtutjeshme administrative dhe se paditësi me padi ka kërkuar mbrojtjen gjyqësore për shkak të heshtjes administrative andaj padia e paditësit nuk mund të konsiderohet si e parakohshme dhe të konstatohet se i njëjti nuk i ka shterur mjetet juridike.

Gjykata e shkallës së parë mbi bazën e konstatimeve të Gjykatës së Apelit dhe po ashtu referimit në hapje të shqyrtimit gjyqësor fillimisht ka vlerësuar se a janë plotësuar kushte për hapjen e shqyrtimit gjyqësor duke ju referuar Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), përkatësisht nenit 9, i cili përcakton se: *“Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative”.* Ndërsa me nenin 14 të Ligjit për Konfliktet Administrative përcaktohet se : *“Konflikti administrativ mund të fillojë edhe kur*

organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës, nën kushtet e parashikuara me këtë ligj. Kurse, me nenin 29 të Ligjit për Konfliktet Administrative përcaktohet: ‘‘3. Nëse organi i shkallës së parë, kundër aktit të të cilit mund të bëhet ankesa, nuk ka nxjerrë asnjë vendim në bazë të kërkesës brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh ose në një afat më të shkurtër të paraparë me dispozita të veçanta, pala ka të drejtë t’i drejtohet me kërkesë organit të shkallës së dytë. Kundër vendimit të organit të shkallës së dytë, pala mund të fillojë konfliktin administrativ, por mundet, nën kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni, ta fillojë edhe nëse ky organ nuk ka nxjerrë vendim’’. Gjkata e shkallës së parë iu ka referuar edhe nenit 81 paragrafi 2 dhe neni 82 par.2 të Ligjit për Shërbimin Civil, nenit 2 të Ligji për Zyrtarë Publik si dhe nenit 127 paragrafi 4 dhe nenit 130 paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën Administrative.

Po ashtu duke mare parasysh periudhën e inicimit të procedurës administrative gjykata e shkallës së parë i është referuar dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenit 124, paragrafi 6, nenit 125 paragrafi 1 si dhe nenit 127. Nga shkresat e lëndës konstatohet pozita e këtu paditësit referuar periudhës kontestuese zyrtar i mbledhjes së detyrueshme, me fillim të kontratës 07.12.2004-ATK. Kurse nga kërkesa e datës 08.06.2021 konstatohet kërkesa për njohjen e të drejtës në 0,5 % në emër të përvojës së punës së kaluar. Me aktin-përgjigje të datës 27.07.2021 e paditura është përgjigje në kërkesën e këtu paditësit me konstatimet si në këtë përgjigje. Mbi bazën e provave të konstatuara, gjykata e shkallës së parë fillimisht kishte në vëmendje statusin dhe pozitën e paditësit (referuar periudhës kontestuese) si i punësuar në ATK si zyrtarë i mbledhjes së detyrueshme nga data 07.12.2004 e në këtë kuptim ndaj të njëjtit aplikohen dispozitat e shërbimit civil e që në rastin konkret është e rregulluar edhe e drejta e ankimimit në KPMSHCK. Duke pasur parasysh se paditësi nga shkresat e lëndës është pensionuar më datë 07.11.2019, por se kërkesa referohet në kompensimin për përvojën e punës të kaluar në shkallë prej 0.5 %, e që në këtë kuptim Gjkata e shkallës së parë konstaton se paditësi me datë 09.06.2021 ka parashtruar kërkesë të e paditura për njohjen e të drejtës në 0.5 % në emër të përvojës së punës së kaluar, e që lidhur me këtë kërkesë ka pranuar përgjigjen e datës 27.07.2021 të cilën vet paditësi e ka dorëzuar me precizim e padisë e që në këtë rast me pranimin e përgjigjes lidhur me kërkesën e datë 08.06.2021 nga ana e të paditurës Gjkata e shkallës së parë konstaton se nga ky organ administrativ nuk kemi heshtje administrative dhe se nuk mund të fitohet e drejta që të inicioj procedurën Gjyqësore përderisa nuk i është adresuar KPMSHCK si organ kompetent për shqyrtimin e ankesave në shërbimin civil, në rastin konkret pasi që paditësi ka pranuar përgjigjen e datës 27.07.2021 dhe e cila përgjigje nuk përmban elementet e aktit administrativ në këtë rast nuk përmban po ashtu këshillën juridike atëherë vie

në shprehje aplikimi i nenit 127 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të LPPA, pra nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni 127, është tre (3) muaj, e që nga kjo dispozitë paditësi nuk fiton të drejtën që të parashtrij padi në Gjykatë, por se ekziston afat ligjor për parashtrimin e ankesës e që është tre muaj. Gjykata e shkallës së parë duke pasur parasysh neni 81 të Ligjit për Shërbimin Civil, ndaj përgjigjes së të paditurës apo heshtjes së saj se paditësi ka mund të adresohet pranë KPMSHCK dhe po ashtu në kuptim të nenit 24 të Ligjit për Zyrtarët Publik referuar periudhës së datës 08.06.2021 kur dhe këtu paditësi ka iniciuar kërkesën pranë këtu të paditurës, në kuptim të kësaj dispozite paditësi në cilësi të nëpunësit civil ka pasur të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Andaj në këtë kuptim konstatohet mos plotësim i kushteve ligjore në kuptim të nenit 13, 14 dhe 29 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në raport me të paditurën si në plotësimin e padisë.

Gjykata e shkallës së parë gjatë shqyrtimit të lëndës kishte parasysh pretendimet e palës paditëse në padi, plotësim e padisë dhe shkresave të lëndës vlerëson se të njëjtat janë të pa bazuara, për faktin se në kuptim të Ligjit për Shërbimin Civil në fuqi gjatë periudhës kontestuese dhe po ashtu me Ligjin për Zyrtarët Publik paditësi nuk ka parashtruar mjetet juridike pranë KPMSHCK në kuptim të neni 127 para 3 lidhur me para 1 të LPPA dhe nenit 29 par 3 të LKA-së, në mënyrë që ti drejtohet Gjykatës lidhur me kërkesën nga marrëdhënia e punës për kompensim. Paditësi para gjykatës me padi dhe edhe pas pranimit të aktvendimit për plotësimin dhe precizimin e padisë dhe kërkesëpadiisë nuk ka bashkangjitur kërkesë apo ankesë adresuar KPMSHCK duke pasur parasysh se dispozitat ligjore përkatëse rregullojnë procedurën e ankesë në shërbimin civil, që pastaj të parashtrij padi në Gjykatë, paditësi në asnjë fazë të procedurës nuk ofroi dëshmi që ka vepruar në bazë të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, Ligjit për Shërbimin Civil, Ligjin për Zyrtarët Publik, Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për zhvillimin e procedurës gjyqësore të konfliktit administrativ, ashtu siç parashihen në dispozitat e sipërcituara. *Gjykata e shkallës së parë kishte parasysh edhe vërejtje e Gjykatës së Apelit por se fillimisht ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet për fillimin e shqyrtimit gjyqësor për faktin se Gjykata ka konstatuar në shkresat e lëndës një kërkesë të datës 08.06.2021 të këtu paditësit adresuar të paditurës, pastaj përgjigjen e datës 27.07.2021 të këtu të paditurës dhe i cili akt-përgjigje nuk përmban elementet e duhura të aktit administrativ andaj në kuptim të nenit 127 par 3 të LPPA vie në shprehje afati i ankesës prej tre muaj, e të cilin mjet*

juridik paditësi nuk e ka shterur para KPMSHCK në mënyrë që ti lind e drejta për parashtrimin e padisë. Prandaj duke marrë parasysh arsyet e dhëna më lart, gjykata e shkallës së parë konstaton se padia dhe kërkesa e saj si e tillë është e palejueshme në kuptim të nenit 34, par 1 nënparagrafi 1.1 dhe paragrafi 2, si dhe në kuptim të nenit 29 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Kolegji i kësaj gjykate e vlerëson si të drejtë këtë qëndrim juridik të dhënë në aktvendimin e ankimuar, sepse me nenin 81 par.2 të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës përcaktohet se: *“2. Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës”*. Ndërsa në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës parashihet se vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë. Po ashtu me nenin 124 par.6 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcaktohet se: *“Shterimi i mjetit juridik administrativ të rregullt përkatës, është kusht paraprak për ngritjen e padisë në gjykatën kompetente për çështjet administrative. Përyjashtimisht, mund të ngrihet drejtpërdrejt padi në gjykatë, pa qenë e nevojshme shterimi i mjeteve juridike administrative, në këto raste: 6.1. nuk ekziston organi epror; 6.2. palës së tretë i janë cenuar të drejtat apo interesat juridike nga akti administrativ që zgjidh ankesën, apo 6.3 parashikohet shprehimisht me ligj”*. Ndërsa, sipas nenit 13 të LKA-së, përcaktohet se: *“Konflikti administrativ mund të fillohet kundër aktit administrativ të nxjerr në procedurën administrative të shkallës së dytë, ose kundër aktit administrativ të nxjerrë në shkallë të parë, kundër të cilit nuk është i lejuar ankimi”*. Andaj, në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka gjetur se vendimi i të paditurës i goditur me padi nuk është akt përfundimtar në procedurën administrative, dhe se nuk ka prova që vërteton se paditësi i ka shterur të gjitha mjetet e brendshme juridike, për të hapur konfliktin administrativ në gjykatë. Sepse me nenin 29 të LKA-së, përcaktohet se: *“1. Nëse organi i shkallës së dytë nuk e ka nxjerrë vendimin brenda tridhjetë (30) ditësh ose në një afat më të shkurtër të caktuar me dispozita të veçanta rreth ankimit të palës kundër vendimit të organit të shkallës së parë, ndërsa nuk e nxjerr as në afatin e mëtejshëm prej shtatë (7) ditësh me kërkesë të përsëritur, pala mund të fillojë konfliktin administrativ sikur t’i është refuzuar ankesa. 2. Në mënyrën e parashikuar në paragrafin 1. të këtij neni mund të veprojë pala edhe kur sipas kërkesës së saj nuk është nxjerrë vendimi nga organi i shkallës së parë, kundër aktit të të cilit nuk mund të bëhet ankesa. 3. Nëse organi i shkallës së parë, kundër aktit të të cilit mund të bëhet ankesa, nuk ka nxjerrë asnjë vendim në bazë të kërkesës brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh ose në një afat më të shkurtër të paraparë me dispozita të veçanta, pala ka të drejtë t’i drejtohet me kërkesë organit të shkallës së dytë. Kundër*

vendimit të organit të shkallës së dytë, pala mund të fillojë konfliktin administrativ, por mundet, nën kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni, ta fillojë edhe nëse ky organ nuk ka nxjerrë vendim”.

Prandaj, pretendimet ankimore të paditësit se gjykata e shkallës së parë pa të drejtë nuk e ka vërtetuar fare në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike edhe përkundër që Gjykata e Apelit e udhëzoi që në riporcedurë- rigjykim duhet ti ftoj palët dhe të hap shqyrtimin kryesor të bëjë administrimin e provave dhe vlerësimin e të gjitha provave materiale veç e veç dhe në mënyrë të tërësishme, atë nuk e bëri dhe mori vendimin sikur herën e parë. Andaj si i tillë ky aktvendim përmban shkelje esenciale të dispozitave ligjore sepse paditësi i ka shfrytëzuar mjetet por e paditura qëllimisht e ka neglizhuar dhe nuk i ka lëshuar kurrfarë vendimi. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, sepse në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar se paditësi nuk ka shterur të gjitha mjetet juridike para organeve administrative, sepse është fakt se paditësi edhe pas pranimit të aktvendimit për plotësimin dhe precizimin e padisë dhe kërkesëpadisë nuk ka bashkangjitur kërkesë apo ankesë adresuar KPMSHCK duke pasur parasysh dispozitat ligjore përkatëse të lartcekura që rregullojnë procedurën e ankesë në shërbimin civil, që pastaj të parashtrij padi në Gjykatë.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Kolegji i kësaj gjykate shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se janë të pa bazuara dhe të pa argumentuara në prova konkrete dhe nuk kanë mbështetje ligjore për tu aprovuar ankesa. Prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e hedhjes poshtë si të parakohshme të padisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore një aktvendim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë, kolegji vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 209 pika b) të LPK-së të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, për të vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2021:200779
Datë: 10.07.2024
Numri i dokumentit: 05920962

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.356/2023, më datë 08.07.2024

Kryetari i kolegji
Ramiz Kuqi